



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Dt.07.09.2023

Në bazë të nenit 72 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, nenit 37 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) në lidhje me kontratën me nr. të protokollit 02nr.410/04-2153, për shkak të mos-përmbyshjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktuesit: N.T.SH.“Viktorij Com ”& Company “Murseli” sh.p.k.- rr.”Tirana” Gjakovë, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore, më dt. 07.09.2023, AK Komuna e Gjakovës, respektivisht Zyra e Prokurimit, merr:

VENDIM

Për ndërprerjen e Kontratës

1. Për shkak të dështimit për të përmbyshur obligimet kontraktuale, që parqet element thelbësorë të kontratës, Kontrata me numër të prokurimit: 632-19-2013-5-1-1, numër të brendshëm 632-19-016-511 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-2153, e datës 22.01.2020, për realizimin e kontratës: ‘Ndërtimi I rrugës së Radoniqit“-Kontratë trivjeçare’’, e lidhur mes në mes të AK Komuna e Gjakovës dhe N.T.SH.“Viktorij Com ”& Company “Murseli” sh.p.k.- me seli rr.”Tirana” Gjakovë, NDËRPRITET .
2. Për shkak se Kontraktuesi: N.T.SH.“Viktorij Com ”& Company “Murseli” sh.p.k.- me seli rr.”Tirana” Gjakovë, është përgjegjës për mos përmbyshje të obligimeve që dalin nga kontrata, obligime këto që janë kusht esenciale dhe themelor i kontratës, NDËRPRITEN së vepruari të gjitha raportet dhe marrëdhëniet Autoritet Kontraktues – Kontraktuesi, të rregulluara me Kontratën 632-19-2013-5-1-1, numër të brendshëm 632-19-016-511 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04-2153, të datës 22.01.2020, për çka Autoriteti Kontraktues, do të do të ndërmarrë veprimet e nevojshme procedurale – ligjore në pajtim me Kushtet e Kontratës.
3. Me qëllim të kompensimit të dëmeve të shkaktuara nga veprimet e pajustificuara të Kontraktuesit, Autoriteti Kontraktues do të ndërmarrë veprimet e nevojshme procedurale – ligjore në pajtim me Kushtet e Kontratës.

4. Ky Vendim hynë në fuqi dhe zbatohet nga data e marrjes.

A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës, në cilësinë e Punëdhënësit, ka iniciuar aktivitetin për: “Ndërtimi I rrugës së Radoniqit“-Kontratë trivjeçare”, të dt.22.01.2020, me O.E: N.T.SH.“Viktory Com ”& Company “Murseli” sh.p.k.- me seli rr.”Tirana” Gjakovë, për kryerjen e punëve të kontraktuara sipas Kontratës.

Me qëllim të menaxhimit dhe zbatimit në kohë dhe në mënyrë cilësore të kontratës, Zyrtaari Kryesorë Administrativ i Autoritetit Kontraktues – Ardian Gjini, Kryetari i Komunës, me Vendimin e tij , ka emëruar Menaxherin e Kontratës, me të drejta dhe obligimet sikurse janë përcaktuar në Vendim.

Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues, në zbatim të detyrave dhe përgjegjësi të tija, përmes kërkesës dërguar në rrugë elektronike ne Zyrën e Prokurimit me date 28.08.2023, ka kërkuar nga Udhëheqësi i zyrës së Prokurimit ndërprerjen e Kontratës për mos realizim te kontratës konform kushteve të kontratës.

Duke qenë se Kontraktuesi: N.T.SH.“Viktory Com ”& Company “Murseli” sh.p.k.- me seli rr.”Tirana” Gjakovë, në vazhdimësi, dhe deri më sot, dt.07.09.2023, nuk është përgjigjur pozitivisht në kërkesat e AK Komuna e Gjakovës. për të kryer te gjitha punët sipas kërkesave teknike të saktësuar në Dosjen e Tenderit , këto veprime të Kontraktuesit, nga ana e AK Komuna e Gjakovës, janë vlerësuar të paarsyeshme, prandaj kontrata ndërpritet duke u bazuar ne nenin 37, paragrafët, a dhe f te Pjesa II e Kontratës – Kushtet e Përgjithshme.

Bazuar në këtë që u tha më lartë, AK Komuna e Gjakovës, përfundimisht ka vlerësuar se Kontraktuesi N.T.SH.“Viktory Com ”& Company “Murseli” sh.p.k.- me seli rr.”Tirana” Gjakovë, duke mos zbatuar kërkesat e AK Komuna e Gjakovës, për zbatim të plotë të kontratës, është përgjegjës për shkak të dështimit të tij për të kryer punet e kontraktuara konform kërkesave dhe Specifikave Teknike të shërbimit.

Andaj, për arsyet sikurse u theksua në këtë Vendim dhe në pajtim me dispozitat nenit 72 të Rregullave te Prokurim Publik është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

UDHËZIM JURIDIK :

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues me marrjen e këtij Vendimi ka shkelur Ligjin apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë ankese pranë Gjykatës Themelore – Departamentit për Çështje Ekonomike në Prishtinë, brenda afatit prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Ardian Gjini

Kryetari i Komunës



Faton Gutaj

Zyrtar përgjegjës i prokurimit



Vendimi t'i dorëzohet:

Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Drejtorisë për Infrastrukturë;
Drejtorisë për Buxhet dhe financa
Organit Mbikqyres "AL-Engineering";
Menaxherit të kontratës;
Arkivës së Komunës.